



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSA NGA MINISTRIA E ARSIMIT, RINISË DHE
SPORTIT TË REPUBLIKËS ÇEKE NË PROGRAMIN E SHKOLLËS VERORE PËR
STUDIMET SLLAVE 2024**

Ambasada e Republikës së Çekisë njofton se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke ofron 2(dy) bursa në programin e Shkollës Verore për Studimet Sllave, 2024.

Numri i vendeve të rezervuara për Republikën e Shqipërisë është vendosur duke u bazuar në marrëveshjen midis Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin në fushën e arsimit 2015-2018, të zgjatur.

Studentët shqiptarë, mbi 18 vjeç, specialistë ose akademikë që studiojnë gjuhën çeke, si dhe të gjithë ato që janë të interesuar për gjuhën dhe kulturën çeke, janë të ftuar të marrin pjesë. Kurset janë të përgatitur për fillestarë, me njohuri të ndërmjetme dhe të avancuara në gjuhën çeke. Një bursë ofrohet nga Charles Universitz në Pragë (18 korrik-15 gusht) dhe një bursë nga Masaryk Universitz në Brno (20 korrik-17 gusht). Institucionet pritëse çeke mbulojnë shpenzimet për regjistrimin, tarifën e kursit, akomodimin, ushqimin dhe ekskursionet.

Një informacion i detajuar rreth formës së aplikimit dhe dokumentave të tjerë gjendet në website-in e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke: <http://www.msmt.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies-2024>

Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet postës, brenda datës 3 mars 2024, dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

- Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës çeke e firmosur nga vetë personi, ku të vendoset adresa elektronike dhe numri i telefoni;
- Formularin e aplikimit;
- Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I dhe/ose II të studimeve të larta ose pasuniversitare;
- Kopjen e noterizuar të listës së notave;
- Vërtetimin nga universiteti përkatës për kandidatët që ndjekin aktualisht studimet universitare/pasuniversitare;
- Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
- 2 (dy) fotografi;
- CV në anglisht.